



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KRUJË

V E N D I M

Nr. 105, datë 02.10.2020

**“PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR  
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM ZONA 1, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË,  
BASHKIA KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 44, datë 22.01.2020 “Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim në Njësinë Administrative Krujë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar,

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
  - a) Dokumenti i Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë;
  - b) Materiali Hartografik.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI**

**ARTUR BUSHI**

